



Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 13.06.2018

Lënda: Mbi ceshtjen penale ne ngarkim te Emiljano Shullazit, etj.

Drejtuar: Drejtuesit te Prokurorise per Krimet e Renda
Zonjes Donika Prela

Per Dijeni:

Tiranë

E Nderuar,

Ceshtja ne ngarkim te Emiljano Shullazit, etj., ka qene nje nder ceshtjet qe ne dy vitet e fundit ka terhequr vemendjen e opinionit publik. Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, etj., jane akuzuar per vepra penale te renda dhe opinionit i jane servirur si perfaqsuesit me te spikatur te botes se krimtit.

Jo gjithmone e verteta lidhur me kete ceshtje eshte bere e njojur dhe kjo ka krijuar ne opinion idene se po ndeshkohet nje grup i rrezikshem kriminal, ndersa prokuoret e ceshtjes kane marre pamjen e kaloresve ne kete beteje kunder krimtit.

Kjo situate ka demtuar shqyrtimin e “ftohte” dhe “te paaneshem” te kesaj ceshtjeje, ka dhunuar parimin madhor te prezumimit te pafajsise dhe tashme qe ceshtja ka mbrritur ne finish, rrezikon qe paragjyktimi dhe zhurma e krijuar rreth saj, te mos lejoje si perfaqsuesit e akuzes, ashtu dhe vete gjykaten qe te vendosin sipas “*liberum arbitrium*”, pra, sipas zgjedhjes se tyre te lire, sipas bindjes se bazuar mbi prova dhe vetem mbi to.

Kjo na detyron qe te terheqim vemendjen tuaj ne kete moment delikat, jo per te kerkuar qe te ndikoni ne vendimarrjen e prokuoreve te ceshtjes, pasi ata jane te pavarur sipas ligjit, por, per te garantuar se ne vendimarrje ata do te jene te pandikuar si nga opinioni i krijuar tashme rreth personave te pandehur, ashtu dhe nga ndikime te tjera te ish drejtuesve te prokurorise, te cilet sikunder ka rezultuar edhe ne gjykimin e ceshtjes, kane patur nje rol negativ e nxites te paligjshmerise.

Procedimi penal ndaj Emiljano Shullazit, etj., ka filluar ne menyre te kundraligjshme. Ne daten 17.04.20116, ish-Drejtuesi i Prokurorise per Krimet e Renda, Besim Hadarmataj, ka urdheruar regjistrimin e procedimit penal Nr.76 te vitit 2016, ne ngarkim te Emiljano Shullazit, Gilmando Danit dhe Blerim Shullazit. Baze per fillimin e ketij procedimi jane te dhenat e perfituara nga kqyrja e faqes se internetit “Balkanweb”, dhe konkretisht deklarimet e shtetasit Sali Berisha per autoresine e kanosjes kunder Mynyr Konit dhe Dhori Kules, ndersa te dy keta persona nuk i kane identifikuar autoret e kanosjes !?



Prokuroria ne kete rast ka vleresuar si burim te proves nje “*Procesverbal per kqyrjen e medias elektronike Balkanweb dt.16.04.2016, bashkengjitur nje CD-R maxell, me mbishkrimin S.Berisha per Koni, dt.16.04.2016*”, por nuk ka pyetur shtetasin Sali Berisha.

Po keshtu, oficeri i policise gjyquesore, Petrit Gjecaj, ka perpiluar dy informacione per referimin e vepres penale, nje ne daten 09.02.2016 dhe tjetri ne daten 26.02.2016. Ne te dy informacionet nuk ka asnje njoftim real mbi veprime konkrete te Emiljano Shullazit, etj, por vetem njoftime te marra nga shtypi, te cilat nuk jane pasuar nga asnje verifikim.

Konkretisht, oficeri i policise Petrit Gjecaj, e fillon informacionin e tij me fjalet:

“Pas deklarates se bere nga gazetari Artan Hoxha ne emisionin televiziv te Tv Klan, duke u shqetesuar si oficer i policise gjyquesore, ne menyre operative kam bere disa verifikime dhe hetime ku e shoh te arsyeshme qe te informoj derejtuesin e Prokurorise per Krime te Renda per nisjen e hetimeve kryesisht per disa shtetas te dyshuar si gjabevenes ndaj disa biznesmeneve te fuqishem ne Shqiperi. Sipas deklarates se bere nga gazetari Artan Hoxha ne emisionin “Opinion Tv Klan” te gazetarit Blendi Fevziu, nje bisnesmen i fuqishem i tregut shqiptar ndjehet i rrezikuar per jeten e tij dhe te biznesit pas nje gjobe te bere nga nje grup kriminal.

Pasi degjova deklaratene, ditet ne vazhdim, ndoqa te gjitha prononcimet dhe deklaratat e bera nga gazetaret e ndryshem te mediave, institucionet politike dhe institucionet te ndryshme te vendit dhe me informacionet e gjetura ne rrjetet arrita te krijoj nje dyshim se duhet te gjenden prova per nisjen e e hetimeve per personat e dyshuar per kryerjen e kesaj vepre penale.

Dyshimet e para ishin per shtetasin Emiljano Shullazi, personi me i perfolur ne keto vite, i cili ka qene edhe i dyshuar per shume vepra penale, si kanosje dhe kercenime gjate ketyre viteve dhe per grupin e tij kriminal per te cilin te gjithe njerezit ne Tirane-Durrës dhe ne media flasin cdo dite.”

Ne vijim, ne kete informacion permenden dhe emra personash te tjere, qe sipas Gjecajt, rezultojne *“nga informacione te siguruara ne rruge operative nga burime dhe individe qe kane informacion per grupet e dyshuara si kriminale”*.

Akti procedural eshte titulluar: *“Procesverbal kqyrje dhe marrje materialesh qe gjeneron sistemi Google i dt. 09.02.2016, ku gjenden te dhena te pasqyruara nga mediat e shkruara dhe vizeve per aktivitetin kriminal te shtetasit Emiljano Shullazi dhe grupi i tij”*.

Nje dite me pas, Drejtuesi i Prokurorise per Krimet e Renda Besim Hadarmataj, ka urdheruar regjistrimin e procedimit penal Nr.26 te vitit 2016, duke iu referuar informacionit te Oficerit te Policise Gjyquesore Petrit Gjecaj.

Zonja Drejtuese e Prokurorise,



Misioni PAMECA ne “Raportin e ecurise per simestrin e gjashte” Mars-Gusht 2016, ka kryer nje vleresim te shkurter te hetimit te policise dhe te prokurorise lidhur me Emiljano Shullazin. Vleresimi tregon se hetimet nuk jane kryer ne menyre te thelluar, objektive dhe te gjithanshme per te arritur nje rezultat konkret ne menyren me te shpejte te mundeshme. Sipas PAMECA-s, *faktet pershkruhen ne menyre te vaket e te pergjithshme, pa ndonje reference kohore dhe vendi te sjelljes se supozuar kriminale, per shembull, te modaliteteteve te kercenimeve te bera, , dhe pa ndonje reference per burimin e provave te mbledhura (pergjime, deklarimedeshmitaresh, etj.,) dhe per personelin e angazhuar ne hetim.*

Ne kete raport preket edhe fakti qe ceshtja ka ndjeshmeri politike, por rapporti thekson se karakteristikat e kesaj ndjeshmerie, *nuk jane te qarta per momentin.*

Shqyrtimi gjyqesor i ceshtjes, vertetoi jo vetem saktesine e ketij konstatimi, por shkoi edhe me tej, vertetoi “*zillin*” per t'u sherbyer *interesave politike* apo edhe *klienteliste*, ne kurriz te zbulimit te se vertetes dhe vertetimit te fajesise te personave te arrestuar.

Gjyqtari i Gjykates se Shkalles se Pare per Krimet e Renda, Idriz Mulkurti, i cili ishte gjyqtari qe vleresoi dhe caktoi masen e sigurimit per Emiljano Shullazin dhe Gilmando Danin, pas reportit te PAMECA-s, duke ndjere pergjegjesine e tij ne ngutjen per vendimarrjen ne kete rast, me rastin e shqyrtimit te kerkesave per caktimin e mases se sigurimit per Endrit Qyqen dhe Endrit Zelen, i paraqiti Kryetarit te Gjykates doreheqjen. Edhe pse doreheqja nuk u pranua nga kryetari, veprimi i gjyqtarit Mulkurti eshte kuptimplotë dhe domethenes!

E ndodhur ne veshtiresi, ne nje ceshtje te filluar pa prova por me buje te madhe, prokuroria gjeti si “*gome shpetimi*” shtetasin Ylvi Beqja, i cili sikunder rezultoi me pas nga shqyrtimi i ceshtjes gjyqesore rezultoi teresisht i perdonur dhe i manipuluar nga organi i akuzes, me qellim qe te mbeshteste akuzen e “*shtrengimit per dhenie pasurie*”, sipas nenit 109/b te Kodit Penal, per ish-Hotel “Vollgen”, ne Durrës.

Shtetasi Ylvi Beqja, deri ne korrik 2016, kishte mbajtur qendrimin edhe publikisht se marrdheniet e tij me Emiljano Shullazin dhe Gilmando Danin, kishin qene marrdhenie miqesore dhe se nuk kishte patur nga dy keta te fundit asnje veprim kanosje, dhune psikike apo fizike kunder tij (*regjistrimi audio i intervistes dhene nga Ylvi Beqja gazetares se BIRN, e administruar si prove nga gjykata*).

Shtetasi Ylvi Beqja edhe ne prokurori sipas dijenise tone deri para muajit korrik 2016 ka dhene shpjegime ne te njejten linje me ato qe kishte thene ne interviste publikisht, por ky procesverbal u fsheh dhe nuk iu dha as te pandehurve dhe as mbrojtvese te tyre.

Ne muajin korrik, shtetasi Ylvi Beqja ndryshoi qendrim dhe po t'i referohemi deshmise se dhene ne gjykate nga avokatet Nexhdet Kambo e Alban Qafa, ky ndryshim ishte pasoje e presionit te ardhur nga prokuroria. Por, deklarimet e tij binin ndesh me deklarime te deklaruesve te tjere dhe ne menyre te vecante me deklarimet e noteres Aida Spahiu.



Per te mbeshtetur pretendimet e tij, ky i fundit citoi ne deklarim shoferin dhe bodigardin e tij, Romeo Tarja, por kur ky u pyet nga prokuroret ai mohoi te kishte dijeni per dhunen fizike dhe psikike te ushtruar nga Shullazi ndaj Beqes, perkundrazi konfirmoi marrdheniet e tyre shume te mira dhe miqesore. Ne keto rrrethana, Ylvi Beqja zevendesoi emrin e tij me emrin e vellait, te lidhjes se tij jashtemartesore, shtetasin Besnik Musaj dhe prokuroret zevendesuan procesverbalin e pare ku permendej shtetasi Romeo Tarja me nje te dyte qe mbante te njejtene date dhe ore, ku ne vend te Romeo Tares ishte permendor Besnik Musaj.

Per kete moment, nga ana e Emiljano Shullazit dhe Gilmando Danit, u paraqit edhe nje kallzim penal, qe iu be me dije edhe gjykates. Ky kallzim mbeti pa veprime, deri ne momentin kur te siperpermendurit ju drejtuan Drejtueses se ONM, Zonjes Kalavera dhe Ambasadorit te SHBA ne Tirane. Pas kesaj, Prokuroria e Pergjithshme, e dergoi per veprim ne Prokurorine e Rrethit Tirane, e cila vendosi “mosfillimin e procedimit” !?

Shtetasi Besnik Musaj u muar ne mbrojtje, si familjar i Ylvi Beqes, per te mbeshtetur ne gjyq “kunatin” e tij. Perpjekjet dhe kerkesat per te sqaruar rrugen se si kishte perfunduar si “deshmitar i mbrojtur” Besnik Musaj, rane ne vesh te shurdher. Procesverbali i pyetjes se tij ne fazen e hetimeve paraprake nuk iu be asnjehere me dije as te pandehurve as mbrojtesve te tyre.

Per te “cimentuar” deklarimet e dhena nga Ylvi Beqja, dhe njekohesisht per ti ofruar opinionit publik, te kunderten e asaj qe deri atehere ishte pranuar edhe si pasoje e Raportit te PAMECA-s, prokuroria kerkoi qe te behej sigurimi i proves i thenjeve te Ylvi Beqes si bashkeipandehur ne nje procedim te lidhur, veprim ky i cili u be me shkelje proceduriale flagrante, nder te cilat me e rendesishmja ishte mungesa e te pandehurve gjate dhenies se deklarimeve te Ylvi Beqes para gjykates.

Ndryshimet e reja ne Kodin e Procedures Penale dhe konkretisht urdherimi i dispozites se nenit 304 pika 1, detyron prokurorine “*te kryje hetime edhe per verifikimin e fakteve ose rrrethanave ne favor te personit ndaj te cilit zhvillohen hetime*”. Kjo gje nuk ka ndodhur ne rastin ne fjale duke caktuar rende dhe nje parim tjeter sic eshte ai i percaktuar ne nenin 4 te K.Pr.Penale sic eshte ai i “*Prezumimit te pafajesise*”.

Per gjithe sa parashtruan me siper, kerkojme mirkuptimin tuaj, ne perputhje me rendesine qe paraqet kjo ceshtje, t’ia nenshtroni ate nje analize te thelluar institucionale dhe ligjore.

Me konsiderate,
Av. Ravik Gurra Av. Vladimir Meci Av.Denion Bogdani

Mbrojtes te te pandehurve

Emiljano Shullazi Gilmando Dani Endrit Qygja